



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 132/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Faik Ukshinit, për tërheqje nga lista e kandidatëve të certifikuar për anëtarë të Kuvendit komunal në Viti nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 02.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si i palejueshëm apeli i Faik Ukshinit, kandidat për anëtar të Kuvendit komunal në Viti nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

Me datën 01.10.2013 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Faik Ukshini, kandidat për anëtar të Kuvendit komunal në Viti nga subjekti politik PDK, me të cilën kërkon që të tërhiqet nga lista për anëtar të kuvendit komunal në Viti. Parashtruesi i apelit thekson se ai është punëtor i PTK-së, në Gjilan dhe se me datën 30.09.2013, ka marrë njoftimin nga PTK-ja se duhet të marrë pushim pa pagesë për 2 muaj.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e këtij apeli dhe gjeti se:

apeli është i palejuar

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidatëve nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013. Andaj pala e cila ka parashtruar apel në PZAP nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për tërheqje në KQZ sipas nenit 28.5 të LZP-së. Meqenëse pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së, PZAP-i vendosi se apeli është i palejuar prandaj duke u bazuar në nenin 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 132/2013 më datën 02.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*